-Nj. Ad. Libonik
01.07.2026

STMP

BASHKIA MALIQ
Zyra e Protokollit
Nr. 4103 Prot.
Date 01.07.26 Nënshkrimi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
KORÇË

Korçë, më 26.06.2026

SHPALLJE VENDIMI

Drejtuar: Njesia Administrative Libonik Bashkia Maliq

Për shtetasen : Adriana Mucollari (Trashi), me adrese banimi: Fshati Drithas Njesia Administrative Libonik Bashkia Maliq

Bashkëlidhur po ju dërgojmë shpalljen për vendimin civil nr. 123 dt. 16.02.2026 te Gjykates se Shkalles se Pare te Juridikisonit te Pergjithshem Korce, për t'u afishuar nga ana Juaj njoftimi me shpallje me afat *20 ditor*, dhe pas afishimit kjo shpallje të na kthehet e konfirmuar me vulë e firmë, në gjykatë.

KANCELARE
Geralda Kasuli

U afishua sot në datë _____
Per Rajonin Administrativ/Bashkine _____
(emër, mbiemër, firmë)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
KORÇË

Nr. Regj. Them. 23003-00050-41-2025(607/1185) **Nr. vendimit 41-2026-515(123)**
Data e regjistrimit 17.01.2025 **Dt. Vendimit 16.02.2025**

VENDIM
"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, e përbërë nga:

GJYQTAR
SUZAN BUSHI

Në Korçë, sot më datë 16.02.2025, asistuar nga sekretare gjyqësore Lubiana Kinolli pasi mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore, me dyer të hapura, çështjen me **Nr. Regj. Them. 23003-00050-41-2025(607/1185)**, që i përket:

KËRKUES: **Adriana Muçollari (Trashi),** e bija e Feti dhe Hazbije, e datëlindjes 1984, lindur në Bicaj të Gramshit dhe banuese në fshatin Drithas, Njësia Administrative Libonik, Bashkia Maliq.

PERSON I TRETË: **Çlirim Muçollari,** i biri i Hamdi dhe Fiqirie, i datëlindjes 1972, lindur në Velçan të Korçës dhe banues në fshatin Drithas, Njësia Administrative Libonik, Bashkia Maliq. (në mungesë).

OBJEKTI: Dhënia e autorizimit nga gjykata që fëmijët e mitur Andrea Muçollari, i datëlindjes 23.06.2008, Aleandro Muçollari, i datëlindjes 02.01.2012, dhe Mariglen Muçollari, i datëlindjes 14.05.2013, të kalojnë lirisht jashtë kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë nën shoqërinë e paditëses Adriana Muçollari (Trashi), pa pëlqimin e atit të tyre, të padituri Çlirim Muçollari, si dhe autorizimi i paditëses për kryerjen e veprimeve juridike që vijnë në interes të fëmijëve të mitu..

BAZA LIGJORE: Nenet 58 dhe 159 të Kodit të Familjes. ".

Gjykata pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në prani të palës kërkuese dhe në mungesë të personit të tretë,

VËREN:

1. **PROCEDURA**

Se, pranë Gjykatës të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, më datë 26.09.2025, është regjistruar kërkesëpadia me palë, objekt dhe bazë ligjore si më sipër.

Përpara shqyrtimit të bazueshmërisë në ligj e në prova të padisë, gjykata analizoi juridiksionin dhe kompetencën e saj në gjykimin e çështjes dhe në bazë të neneve 36 (1), 42/1 349 të Kodit të Procedurës Civile, nenit 58 dhe 159 të Kodit të Familjes si dhe nenit 11/1 të ligjit nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", gjykata konstatoi se çështja hyn në juridiksionin gjyqësor dhe është në kompetencën lëndore e tokësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

2. RRETHANAT E ÇËSHTJES.

Nga aktet e administruara rezulton se paditësja Adriana Muçollari (Trashi) dhe i padituri Çlirim Muçollari kanë qenë të martuar me njëri-tjetrin, marrëdhënie martesore e cila është zgjidhur me vendimin nr. 41-2020-1145 (371), datë 19.05.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Nga kjo martesë kanë ardhur në jetë disa fëmijë, ndër të cilët Andrea Muçollari, i datëlindjes 23.06.2008, Aleandro Muçollari, i datëlindjes 02.01.2011/2012, dhe Mariglen Muçollari, i datëlindjes 14.05.2013, për të cilët në këtë gjykim kërkohet dhënia e autorizimit për dalje jashtë shtetit nën shoqërinë e nënës së tyre.

Me vendimin e sipërcituar për zgjidhjen e martesës, fëmijët e mitur i janë lënë për rritje dhe edukim nënës së tyre, paditëses Adriana Muçollari (Trashi), ndërsa atit të tyre, të paditurit Çlirim Muçollari, i është njohur e drejta për t'i takuar dhe marrë fëmijët sipas grafikut të përcaktuar në vendim. Po me këtë vendim, i padituri është detyruar të paguajë pension ushqimor në favor të fëmijëve, konkretisht shumën 7.000 lekë në muaj për Xhensila Muçollari, 5.000 lekë në muaj për Andrea Muçollari, 4.000 lekë në muaj për Aleandro Muçollari dhe 4.000 lekë në muaj për Mariglen Muçollari.

Paditësja ka parashtruar se vendimi për zgjidhjen e martesës ka marrë formë të prerë dhe është vënë në ekzekutim pranë përmbaruesit shtetëror lidhur me detyrimet për pension ushqimor. Sipas saj, deri në momentin e paraqitjes së kërkesës, i padituri nuk ka realizuar pagesat e detyrueshme për fëmijët e mitur dhe nuk ka treguar kujdes material e moral ndaj tyre. Po ashtu, paditësja ka pretenduar se i padituri nuk ka denjuar të zbatojë as vendimin në pjesën që lidhet me takimin e fëmijëve, sipas kohëve të përcaktuara nga gjykata.

Paditësja ka pretenduar se, megjithëse ndodhet në kushte të vështira ekonomike, ka bërë përpjekje për mirërritjen, edukimin dhe përkujdesjen ndaj fëmijëve, duke punuar në bujqësi apo në punë të tjera të mundshme për të siguruar të ardhurat minimale për familjen. Në kushtet kur mundësitë për punë në vend janë të kufizuara dhe nuk arrin të përballojë nevojat minimale të jetesës, ajo ka kërkuar të punojë sezonalisht jashtë shtetit, me mbështetjen e të afërmve të saj për strehim dhe gjetje pune.

Kërkesa është paraqitur për shkak se, sipas paditëses, i padituri nuk ka dhënë mirëkuptimin e nevojshëm për lejimin e daljes së fëmijëve jashtë shtetit, ndërkohë që ajo vlerëson se largimi i

përkohshëm jashtë vendit dhe mundësia për punësim do t'i shërbejnë interesit më të lartë të fëmijëve, duke mundësuar sigurimin e të ardhurave më të mira dhe përkujdesjen e tyre materiale.

Në këto rrethana, paditësja i është drejtuar gjykatës me kërkesë për dhënien e autorizimit që fëmijët Andrea Muçollari, Aleandro Muçollari dhe Mariglen Muçollari të kalojnë lirisht jashtë kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë nën shoqërinë e saj, pa pëlqimin e atit të tyre, të paditurit Çlirim Muçollari, si dhe për autorizimin e saj për kryerjen e veprimeve juridike që vijnë në interes të fëmijëve të mitur.

3. VLERËSIMI I GJYKATËS.

Gjykata, pasi mori në shqyrtim aktet e administruara në dosje, objektin e kërkesëpadisë, si dhe zhvillimin procedural të çështjes, vlerëson se në rastin konkret gjykimi duhet të pushohet, për shkak të mungesës së palës paditëse në seancë gjyqësore.

Nga aktet e administruara rezulton se paditësja Adriana Muçollari (Trashi) i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi, me objekt dhënien e autorizimit që fëmijët Andrea Muçollari, Aleandro Muçollari dhe Mariglen Muçollari të kalojnë lirisht jashtë kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë nën shoqërinë e saj, pa pëlqimin e atit të tyre, të paditurit Çlirim Muçollari, si dhe autorizimin e paditëses për kryerjen e veprimeve juridike që vijnë në interes të fëmijëve të mitur.

Në rastin konkret, çështja është thirrur për shqyrtim në seancë gjyqësore, por pala paditëse, e cila ka vënë në lëvizje gjykatën me kërkesëpadinë përkatëse, nuk është paraqitur. Mungesa e saj në gjykim merr rëndësi përcaktuese, pasi kërkimi objekt shqyrtimi lidhet me një autorizim gjyqësor konkret, që kërkon sqarimin e rrethanave faktike mbi qëllimin e daljes së fëmijëve jashtë shtetit, vendin ku do të qëndrojnë, kohëzgjatjen, kushtet e qëndrimit, si dhe garancitë që lidhen me interesin më të lartë të të miturve.

Sipas nenit 179 të Kodit të Procedurës Civile, kur paditësi, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, nuk paraqitet në seancë, gjykata vendos pushimin e gjykimit. Kjo dispozitë shpreh parimin se pala që ka vënë në lëvizje gjykatën ka detyrimin procedural të ndjekë gjykimin dhe të tregojë interes aktiv për shqyrtimin e kërkimit të saj. Në të kundërt, mosparaqitja e saj në seancë, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, sjell si pasojë pushimin e çështjes.

Gjykata mban parasysh se objekti i çështjes lidhet me fëmijë të mitur dhe, për këtë arsye, çdo vlerësim eventual mbi themelin e kërkimit do të duhej të udhëhiqej nga interesi më i lartë i tyre. Megjithatë, ky parim nuk e përjashton zbatimin e rregullave procedurale që lidhen me pjesëmarrjen e palës paditëse në gjykim, veçanërisht kur vetë paditësja kërkon dhënien e një autorizimi personal për shoqërimin e fëmijëve jashtë shtetit dhe për kryerjen e veprimeve juridike në interes të tyre. Në mungesë të saj, gjykata nuk ka mundësi të zhvillojë një shqyrtim efektiv dhe të plotë mbi rrethanat konkrete të kërkesës.

Për rrjedhojë, pushimi i gjykimit në këtë rast nuk përbën vlerësim mbi bazueshmërinë ose pabazueshmërinë e kërkesëpadisë në themel, por është pasojë procedurale e mungesës së paditëses në seancë, në kushtet e parashikuara nga neni 179 i Kodit të Procedurës Civile. Kjo do të thotë se gjykata nuk shprehet mbi të drejtën materiale të kërkuar, por vetëm konstaton pamundësinë procedurale për vijimin e gjykimit për shkak të mosparaqitjes së palës që ka vënë në lëvizje procesin.

Në këto kushte, gjykata çmon se gjykimi i çështjes duhet të pushohet, në mbështetje të nenit 179 të Kodit të Procedurës Civile.

VENDOSI

1. Pushimin e çështjes.
2. Kundër këtij vendimit lejohet ankim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, brenda 5 ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.
3. U shpall me datë 16.02.2026

SEKRETARE
LUBIANA KINOLLI

GJYQTAR
SUZAN BUSHI